

Prindërimi gjatë COVID-19

Si t'i mbani fëmijët të sigurt online

Fëmijët dhe adoleshentët po kalojnë tani më shumë kohë online se më parë. Të qëndruarit i lidhur me botën i ndihmon ata të minimizojnë ndikimin e COVID-19 dhe i inkurajon të vazhdojnë jetën e tyre të përditshme...por kjo paraqet edhe disa rrezeqe.

Rreziqet online



Shenjestrime i fëmijëve nga të rriturit për qëllime seksuale në rrjetet sociale, lojërat online dhe platformat e mesazhimit



Përmbajtje e dëmshme - dhunë, mizogjeni, ksenofobi, nxitje e vetëvrasjes dhe vetëdëmtimit, keqinformimi, etj.



Shpërndarja e informacioneve personale, fotove dhe videove seksuale nga vetë adoleshentët



Bulizmi kibernetik nga bashkëmoshatarët dhe të huajt

Zgjidhje teknologjike për të mbrojtur fëmijët e tuaj kur janë online

- > Vendosni **kontrolle prindërore**
- > Aktivizoni filtrin e Kërkimit të Sigurt në shfletuesin (browser) tuaj
- > Vendosni cilësime strikte të privatisë në aplikacionet dhe lojërat online
- > Mbuloni ueb-kamerat kur nuk përdoren

Krijoni zakone të shëndetshme dhe të sigurta online

- > Përfshini fëmijën ose adoleshtin tuaj në hartimin e marrëveshjeve familjare për teknologjinë dhe përdorimin e duhur të pajisjeve
- > Caktoni disa hapësira në shtëpinë tuaj dhe orare kur nuk do të lejohen pajisjet (kur jeni duke ngrënë, luajtur, duke bërë detyrat e shtëpisë dhe në orarin e gjumit)
- > Ndihmoni fëmijën tuaj të mësojë që të mos ndajë të dhënat personale, veçanërisht me të huajt - disa njerëz nuk janë ata që thonë se janë!
- > Kujtojeni fëmijëve tuaj se çfarë hidhet në internet mbetet aty (mesazhe, foto dhe video)



Kaloni kohë online me fëmijën dhe adoleshtin tuaj

- > Eksploronë së bashku uebsajte, rrjetet sociale, lojëra dhe aplikacione
- > Flisni me adoleshtin tuaj mbi si të raportojë përmbajtjet e papërshtatshme (shihni më poshtë)
- > Common Sense Media ofron këshilla shumë të mira për aplikacionet, lojërat dhe zbavitjen për moshë të ndryshme

Mbani fëmijët tuaj të sigurtë, duke komunikuar hapur me ta

- > Thuajini fëmijëve tuaj se nëse përjetojnë diçka online që i bën të ndihen të shqetësuar, jo rehat ose të frikësuar ata mund të flasin me ju dhe ju nuk do të inatoseni dhe as nuk do t'i ndëshkoni ata
- > Jini vigjilentë ndaj shenjave të ankthit. Vini re nëse fëmija juaj duket më i tërhequr, i mërzhitur, sikur po fsheh diçka ose është i fiksuar pas aktiviteteve online
- > Krijoni marrëdhënie besimi dhe komunikim të hapur duke i mbështetur dhe inkurajuar në mënyrë pozitive
- > Kini parasysh që çdo fëmijë është unik dhe ka mënyrën e vetë të komunikimit. Kushtojini pak kohë përshtatjes së mesazhit me nevojat e fëmijës suaj. Për shembull, fëmijët me vështirësi në të nxënit, duan që informacioni të jetë sa më i thjeshtë



Shpërndajeni me kolegët, miqtë dhe familjen tuaj | Përhapni fjalën | Mbani fëmijët të sigurtë online

Raportoni dhunën ndaj fëmijëve online:

Burime të tjera:

CHILD HELPLINE

LINJAT INHOPE

IWF PORTALS

LIBËRTHI I MBROJTJES

UNICEF

GJUHË TË TJERA

BAZUAR NË FAKTE